VENDIM
Nr. 79/2021

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT "PËR KONTROLLIN E VEPRIMTARISË SË ORGANEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE PUSHTETIT VENDOR, PËR TË VERIFIKUAR PËRDORIMIN E BURIMEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE PËR QËLLIME ELEKTORALE NË ZGJEDHJET E 25 PRILLIT 2021

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës, të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, të neneve 5, 6, 8 dhe 9, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", të ndryshuar, me propozim të 39 deputetëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së jo më pak se 1/4 së deputetëve për të kontrolluar veprimtarinë e organeve të administratës publike dhe pushtetit vendor, për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 25 Prillit 2021. Ky hetim parlamentar do të synojë nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, mbrojtjen e integritetit te procesit zgjedhor, përfshirë garantimin e lirisë së votës, rritjen e besimit të publikut, mirëmenaxhimin e buxhetit të shtetit.

II. Objekti i punës së komisionit hetimor është:

1 Verifikimi i përdorimit të të dhënave personale për qëllime elektorale;

2. Verifikimi i përdorimit të fondeve publike për qëllime elektorale, duke përfshirë edhe shpërblimin e dëmeve nga tërmeti i vitit 2019;

3. Verifikimi i përdorimit të procesit të legalizimeve të ndërtimeve informale për qëllime elektorale;

4. Verifikimi i punësimeve në administratën publike për qëllime elektorale

III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes së pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë.

IV. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, ndryshime të kuadrit ligjor që ofrojnë mbrojtje dhe garanci për integritetin e procesit zgjedhor dhe sipas rastit njoftimin e prokurorisë për fillimin e çështjes penale.

V. Komisioni hetimor përbëhet nga 15 anëtarë si më poshtë:

1. Enkelejd Alibeaj	kryetar	PD
2. Toni Gogu	zëvendëskryetar	PS
3. Klotilda Bushka	anëtare	PS
4. Blerina Gjylameti	anëtare	PS
5. Aurora Mara	anëtare	PS
6. Klevis Xhoxhi	anëtar	PS
7. Nasip Naço	anëtar	PS
8. Petro Koçi	anëtar	PS
9. Bardhyl Kollçaku	anëtar	PS
10. Gazmend Bardhi	anëtar	PD
11. Oerd Bylykbashi	anëtar	PD
12. Ferdinand Xhaferraj	anëtar	PD

13. Ervin Salianji	anëtar	PD
14. Kreshnik Çollaku	anëtar	PD
15. Petrit Vasili	anëtar	deputet i pavarur

1. Xhemal Qefalia	anëtar zëvendësues	PS
2. Etjen Xhafaj	anëtar zëvendësues	PS
3. Arbi Agalliu	anëtar zëvendësues	PD
4. Lindita Metaliaj	anëtare zëvendësuese	PD

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

VII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që të caktojë menjëherë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion ekspertë juristë.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 14.10.2021.